



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
27.6.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Amir Simnica (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Feim Osmani (LVV), Arbër Limani (LVV), Endrit Gashi (AAK) dhe Liridon Selmani, (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Bardh Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Faqe nga 6

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Petrit Reçica tha se, në njërin prej pikave në mbledhjen e kaluar, unë kam votuar kundër, ndërsa në procesverbal del se nuk kam votuar, kështu që kisha kërkuar që, derisa të rregullohet ky problem të vazhdojmë me votim me dorë.

Kryesuesi tha se, para se të vazhdojmë me diskutimet rreth rendit të ditës, sot në mbledhjen e KPF-së është rekomanduar që pika 4 "Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: "Projektplani i zhvillimit komunal 2024-2032" (PZHK) dhe pika 5, "Propozim - vendimi për ndryshimin e riparcialimit sipas gjendjes aktuale kadastrale të banimit individual të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" dhe ndërrimi i destinimit të bllokut 1-1Q-21-2 sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë, të hiqen nga rendi i ditës.

Elmire Nikçi kërkoi të dijë arsyen se pse ka ardhur deri te ky rekomandim dhe çka përmbajnë këto rekomandime të dala nga mbledhja e KPF-së. Pra, pse duhet me u tërhequr këto dy pika prej rendit të ditës.

Gëzim Sveçla tha se për këto dy pika të rendit të ditës, sqarimet i kemi bërë në mbledhjen e KPF-së, ku secili grup është i përfaqësuar në KPF, prandaj propozoj që të vazhdojmë me votimin e rekomandimeve.

Kryetari pyeti se cila është arsyeja që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës, pse dikush voton kundër një rendi të ditës i propozuar prej kryetarit, në marrëveshje me kryesuesin.

Fiknete Bejta tha se do të ishte e palogjikshme që ta shtyjme për më vonë këtë Plan zhvillimor komunal, plan ky i cili ka me u diskutuar me publikun, kështu që për të mos humbur kohë, ta vëmë në diskutim publik.

Arbër Sadiki, drejtor, tha se jemi duke folur për një plan, për një dokument i cili është ndër më të rëndësishmit të kryeqytetit, pra sot jemi duke vendosur vetëm për vënien në diskutim publik dhe pikërisht rruga e vetme është për me u hapur edhe njëherë ai plan, i cili ka shkuar në Ministri edhe me u diskutuar për me u votuar sot, për me dalur në diskutim publik.

Sami Borovci pyeti se pse mos të trajtohet dhe të diskutohet ky plan rregullues, sidomos kur ka të bëjë me lënien në diskutim publik. Te përbërja ose te përmbajtja e dokumentit mundemi me pasur vërejtje, rekomandime, mospajtime, por me propozuar me e hequr nga rendi i ditës, nuk pajtohem dhe kisha pasur dëshirë me e ditë se cili është argumenti që duam me e larguar Planin zhvillimor komunal prej rendit të ditës.

Endrit Zabërgja tha se ne nuk po vendosim që ta kalojmë apo ta aprovojmë në mënyrë absolute PZHK-në, mirëpo këtu po kërkohet që të vihet në diskutim publik, e nëse po kërkohet të vihet në diskutim publik, kush është më mirë se qytetari që do të mund të diskutojë edhe t'i japë propozimet, pëlqimet e veta ndaj çështjes. Besoj se është mjaft e rëndësishme që të futet brenda pikës së rendit të ditës, të diskutohet, të trajtohet të shikojmë se a do ta vendosim në diskutim publik a jo.

Dasmor Durmishi tha se do të ishte mirë që qytetari me e ditur arsyen pse kjo pikë po propozohet që të largohet nga rendi i ditës, andaj kërkojmë nga propozuesi që të na e arsyetojë largimin e kësaj pike nga rendi i ditës.

Ajet Brajshori shprehu mendimin se për hirë të transparencës me qytetarë, është shumë me rëndësi që ky dokument të hidhet në diskutim publik, të dëgjohet edhe zëri i qytetarëve, kështu që në këtë plan zhvillimor përmes diskutimit publik, ne arrijmë t'i plotësojmë edhe ato gjëra që ndoshta kemi pasur ose ka nevojë të plotësohet ky dokument. Vërtetë është e papranueshme të vonohemi ende përderisa është për debat publik.

Hafiz Krasniqi kërkoj të dij arsyen e tërheqjes së këtij plani nga rendi i ditës, me ç'rast bëri thirrje që të votohet ky plan për të shkuar në diskutim publik, në mënyrë që ta kemi një dokument bazik, mbi të cilin duhet të orientohet zhvillimi ekonomik, industrial, social, politik, sportiv dhe të gjitha të tjerat.

Milazim Vitija tha se ky plan zhvillimor komunal nuk është duke u bërë as për LDK-në, as për PDK-në, por është duke u bërë për qytetarët e Prishtinës, prandaj dhe e ka rëndësinë e vetë, kështu që kërkoj nga të gjithë të pranishmit që ta votojmë për të shkuar në diskutim publik.

Pëllumb Bajqinovci tha se është më se e rëndësishme të fillojmë diskutimin, ku në këto diskutime gjithçka mundet me lëvizur për të mirë apo për drejtimin ideologjik që e ka një parti dhe ky është qëllimi. Mesazhi im i fundit pa tensione të vazhdojmë tutje sigurisht në dobi të qytetarëve edhe në përkrahje të të gjitha planeve të cilat jemi duke i finalizuar.

Leutrim Retkoceri tha se jemi para një propozimi, i cili është propozim sa i përket një pike të rendit të ditës, heqjen apo kalimin për diskutim publik të Planit zhvillimor komunal, kështu që kisha kërkuar që votimi të bëhet pa ndonjë ndikim dhe presion, të jetë votim me dorë, me votuar me vullnet të lirë, të hapur të shpërfaqur publikisht para qytetarëve.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 24 kundër dhe 2 abstenime, Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit - Projektplani i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK), mbetet në rendin e ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 20 kundër dhe 1 abstenim, Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcialimit sipas gjendjes aktuale kadastrale të banimit individual të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" dhe ndërrimin e destinimit të bllokut 1-1Q-21-2 sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë, hiqet nga rendi i ditës.

Bahri Gashi pyeti se a ka ndonjë material për pikën e 7-të të rendit të ditës: "Propozim - vendimi për themelimin e komisionit të Kuvendit të Komunës lidhur me propozimin e shfrytëzimit të banesave.

Lidhur me kërkesën e z. Gashi, Adelina Sahiti, drejtore, dha sqarime të nevojshme.

Përparim Rama, kryetar, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për diskutim në njërin nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Faqe3nga6

Me ndryshime të pikave të rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se, më 25 vota për dhe 2 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB);
4. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: "Projektplani i zhvillimit komunal 2024 - 2032" (PZHK);
5. Projektkodi i etikës për zyrtarët e Kryeqytetit;
6. Propozim-vendimi për përkrahjen financiare të klubeve sportive të kryeqytetit dhe eventit sportiv 3x3 Prishtina;
7. Raporti i përgjithshëm i punës së Ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve", SHA, Prishtinë;
8. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024.

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Mirsada Vitia tha se ne si grup i LVV-së, këtë propozim-vendim e mbështesim për miratim.

Fitnete Bejta tha se ne si LDK, e mbështesim këtë propozim për miratim.

Muhamet Selmani u shpreh se ne si Grup parlamentar e përkrahim këtë propozim-vendim, por paraprakisht kërkojmë një sqarim rreth tërheqjes së mjeteve për projektin e rregullimit të urës dhe të disa rrugëve në fshatin Barilevë.

Leutrim Retkoceri u shpreh se projektet të cilat janë prezantuar në këtë bartje, kërkoj nga drejtorët të cilët i kanë kërkuar këto bartje, t'i paraqesin para asamblistëve projektet të cilët neve na bindin dhe dëshmojnë që do të ndodh vërtet realizimi i këtyre mjeteve në projekte dhe nuk do të kemi tepricë apo suficit buxhetor.

Sami Boroci tha se te kodi buxhetor "Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive në Mat dhe Hajvali, veçanërisht ndërtimin e stadiumit në Hajvali, kërkoj të dijë arsyen e bllokimit të këtij projekti.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli, drejtore, Krenar Xhaferi, drejtor, Bekim Brestovci, drejtor dhe Donjeta Dragusha, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB).

Lidhur me këtë propozim-vendim të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Mirsad Vitia tha se Korniza afatmesme buxhetore është ndërtuar mbi planet e shkurtra dhe të fragmentuara, të cilat nuk ofrojnë një vizion të qartë dhe të qëndrueshëm për zhvillimin e qytetit tonë, si për shpenzimet e paarsyeshme dhe planifikimet e pamjaftueshme financiare. Konsultimet publike janë bërë në mënyrë formale dhe nuk kanë reflektuar realisht nevojat dhe preferencat e qytetarëve. Kjo tregon një mos përfillje nga zërat e qyteteve dhe një mungesë të qasjes së qëndrueshme dhe të hapur ndaj transparencës. Shumë nga projektet e mëdha infrastrukturore janë planifikuar pa një studim të thellë të fizibilitetit, ndikimit mjedisor dhe social, kjo vetëm rrit rrezikim për dështimin e projekteve dhe përbën një humbje të madhe të fondeve publike.

Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027 përmban shumë mangësi dhe sfida që duhet të adresohen urgjentisht dhe për të përmirësuar këtë dokument, propozojmë këto pika:

1. Hartimin e një strategjie afatgjate të integruar që të adresojë nevojat reale;
2. Rivlerësimin e projekteve të propozuara dhe alokimin e fondeve drejtë projekteve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në përmirësimin e cilësi së jetës së qytetarëve.

Hafiz Krasniqi tha se para se të përpilohet plani i buxhetit, kisha pasur dëshirë që me çdo drejtor të organizojmë nga një takim të gjitha grupet parlamentare, në mënyrë që ne si përfaqësues të qytetarëve të japim versionet tona aty ku është më se e nevojshme, duke pasur për bazë edhe prioritetin e projekteve.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB).

Faqe 5 nga 6

Pika e katërt

Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt i planit të zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK).

Lidhur me këtë propozim- vendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Arbër Sadiku, drejtor.

Gëzim Sveçla tha se bazuar në vërtjetet e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapsinorë, mund të konstatojmë se ky plan nuk është në përputhje me ligjet dhe dokumentet e tjera, andaj si Grup i Lëvizjes Vetëvendosje nuk e përkrahim këtë projekt që të dalë në diskutim publik. Ju ftojmë dhe kërkojmë nga ju që ta tërhiqni, ta bëni ashtu siç parashihet me ligj edhe me dokumente të tjera, në të kundërtën, ne nuk do të jemi pjesë e votimit të tij dhe do ta lëshojmë sallën.

Jeta Rafuna tha se Grupi i asamblistëve të LDK-së për interes të qytetarëve edhe të zhvillimit të kryeqytetit do të votoj pro këtij plani.

Leutrim Ratkoceri tha se ky dokument më vital i kryeqytetit është përgatitur në mungesë të transparencës për përpilimin e planit, duke kontrabanduar interesa individuale dhe duke dëmtuar interesin publik. PZHK-ja që na është sjellë, është përgatitur nga një grup njerëzish jo kompetent, duke u kontrabanduar përmes arkitektit të qytetit, për të cilin ne si Kuvend nuk kemi asnjë biografi të personave të cilët janë të angazhuar në këtë projekt, a janë profesional apo jo. Hartimi i këtij plani ka edhe shkelje ligjore, sepse na është sjellë për me e dërguar në diskutim publik pa një vlerësim strategjik mjedisor. Ne si grup kërkojmë që kjo pikë të largohet, të bëhen përmirësimet procedurale edhe ligjore dhe të kthehet në votim në tetor, atëherë kur qytetarët kryesisht i mbarojnë pushimet dhe nëse nuk merren parasysh vërejtjet dhe kërkesat tona, ne si Grup parlamentar në shenjë paknaqësie do ta lëshojmë sallën.

Gëzim Mehmeti tha se çështjet e planeve zhvillimore janë komplikuar aq shumë, sa që po vihen në dyshim çështjet e zbatimit të ligjit dhe po kemi standarde të dyfishta. Miratimi i këtij plani është dashtë të bëhet qysh në vitin 2021, kështu që kan kaluar më se tri vjet dhe Prishtina është pa një plan zhvillimor.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme për këtë plan zhvillimor dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Arbër Sadiku, drejtor.

Pas këtyre diskutimeve, në shenjë pakënaqësie, GP i LVV-së dhe GP i PDK-së e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi tha se, në mungesë të kuorumit, mbledhjen e konstatoj të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina

Faqe6nga6

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>

